



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 29, datë 09.08.2022

“Për ndryshimin e vendimit nr 57 datë 26.10. 2020 të afatit të marrjes me qira nga 9 (nëntë) vjekar në 10 vjekar sipërfaqen pyjore prej 0.347 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, në ngastrat nr.40/a në ekonominë pyjore Shllak 1. Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” ,i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës _____._____2022 të Këshillit të Bashkisë të:

V E N D O S I

1. Ndryshimin e vendimit **nr 57 datë 26.10. 2020** për dhënie në përdorim të sipërfaqes në total **0.347** ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” në ngastrat nr.40/a në ekonominë pyjore Shllak 1 sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.
2. Afati i dhënies me qira të jetë 10 (dhjetë) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

KRYETARI
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
Spektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 44 prot.

Vau Dejës, më 03.08.2022

RELACION

Për ndryshim vendimi të keshillit Bashkiak nr 57 datë 26.10.2020.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika e1 neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 7.

Referuar nenit 112 i KPAD, VKM Nr.1064, datë 22.12.2010, lidhja 2 pika 5:1 i propozojme keshillit bashkiak ndryshimin e vendimit nr 57 datë 26.10.2020 të afatit të përdorimit nga 9-të (nëntë) vjecar në 10-të (dhjetë) vjecar duke mos ndryshuar sipërfaqen dhe vlerën.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e vendimit.

Specialistet

Ing.Mark Suli

Ing.Zeqir Ujka

Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni